



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
KRITERET, PROCEDURAT DHE AFATET E LICENCIMIT SI DHE RASTET E
REFUZIMIT TË LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BROKERIMI NË
SIGURIME

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 48, datë 30.06.2015
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 18, datë 26.02.2016
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 26, datë 28.02.2022
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 119, datë 25.07.2025

Kreu I
Të Përgjithshme

Neni 1
Objekti

Kjo Rregullore përcakton kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit, si dhe rastet e refuzimit të kërkesës, të personave që paraqesin kërkesën për t'u pajisur me licencë për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo Rregullore hartohet në bazë të pikës 2 të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenet 204, pikat 5 dhe 6, 209, pika 2, 210, pika 3 dhe 211, pika 2, të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Kreu II
Licencimi i brokerit në sigurime

Neni 3

Kriteret e licencimit të brokerit në sigurime

1. Personi fizik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e brokerimit në sigurime, duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:
 - a) Ka përfunduar studimet universitare;
 - b) Ka përvojë profesionale të paktën dy vjet në fushën e sigurimeve;
 - c) Ka kryer kualifikime profesionale në fushën e sigurimit;
 - d) Gjatë 5 viteve të fundit nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë veprë penale;
 - e) Nuk ka qenë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
 - f) Nuk është i punësuar me kohë të plotë në funksione publike, apo në ndonjë shoqëri sigurimi;
 - g) Nuk ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ndaj të tretëve, si dhe nuk ka detyrime të papaguara ndaj organeve tatimore;
 - h) Nuk i është revokuar më parë licenca sipas parashikimeve të neneve 199 dhe 209 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014.

2. Personi fizik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e brokerimit në sigurime, përveç kërkesave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të kalojë me sukses testimin, e organizuar nga Autoriteti, për njohuritë profesionale dhe legjislacionin në fushën e sigurimeve.

Neni 4

Dokumentacioni për licencimin e brokerit në sigurime

1. Personi fizik që kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e brokerimit, paraqet pranë Autoritetit një kërkesë me shkrim, sipas formë kërkesës të paraqitur në aneksin 1 të kësaj rregullore, të shoqëruar me:
 - a) CV dhe kopje të dokumentit të identifikimit;
 - b) Diplomë universitare;
 - c) Dokument që vërteton përvojën profesionale në fushën e sigurimit;
 - d) Dokument që vërteton kryerjen e kualifikimit profesional;
 - e) Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
 - f) Deklarata në përmbushje të kërkesave të germës e), f) dhe g) të pikës 1 të nenit 3 të kësaj rregulloreje.

- g) Dokument që vërteton se nuk ka detyrime fiskale të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopjetë noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.
 3. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse eçmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 5

Organizimi i testimit

1. Testimi për njohuritë profesionale dhe legjislacionin në fushën e sigurimeve, si kriter për licencimin e brokerit organizohet nga Autoriteti çdo 6 muaj. Njoftimi për zhvillimin e testimit publikohet në faqen zyrtare të AMF-së, 30 ditë para datës së zhvillimit të tij.
2. Testimi përfshin njohuri nga fusha e sigurimit të jetës, Jo-Jetës dhe risigurimet. Aplikanti përzgjedh fushën e testimit. Testimi për çdo fushë quhet i kaluar, kur janë grumbulluar të paktën 60% e pikëve në atë fushë.
3. Testimi zhvillohet me shkrim, në gjuhën shqipe.

Neni 6

Procedura e testimit

1. Personat që plotësojnë kërkesat e neneve 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje, i nënshtrohen testimit për njohuritë profesionale dhe legjislacionin në fushën e sigurimeve. Lista e personave që do t'i nënshtrohen testimit publikohet në faqen zyrtare të AMF-së jo më vonë se një javë nga data e zhvillimit të testimit.
2. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv cakton Komisionin e Testimit. Komisioni i Testimit përbëhet nga 5(pesë) anëtarë nga të cilët:
 - 3 janë punonjës të AMF-së;
 - 2 janë të jashtëm, profesionistë në fushën e sigurimeve, apo specialistë nga fusha akademike.
3. Komisioni i testimit përgatit testet, kryen vlerësimin e tyre dhe evidenton në procesverbal rezultatet e testimit. Rezultatet e testimit publikohen në faqen zyrtare të AMF-së brenda

tetë (8) ditësh pune nga data e zhvillimit të testimit.

4. Pjesëmarrësit e testimit kanë të drejtë të ankimohen për rezultatin e testimit brenda pesë (5) ditëve pune nga data e publikimit të rezultateve.
5. Për shqyrtimin e ankesave, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv cakton një komision të posaçëm. Përbërja e komisionit të shqyrtimit të ankesave duhet të jetë e ndryshme nga ajo e komisionit të testimit.
6. Brenda dhjetë (10) ditë pune nga data e depozitimit të ankesës Komisioni i posaçëm shqyrton ankesën, harton raportin për Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv dhe i kthen përgjigje më shkrim ankimesit.
7. Pas mbarimit të procedurës së ankimit Autoriteti publikon, në faqen zyrtare, rezultatet përfundimtare të testimit.

Kreu III

Licencimi i shoqërisë së brokerimit në sigurime

Neni 7

Kërkesat për licencimin e shoqërisë së brokerimit në sigurime

1. Personi juridik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e brokerimit në sigurime, përveç kërkesave të Ligjit nr. 52/2014, dt. 22.05.2014, duhet të plotësojë edhe kërkesat si më poshtë:
 - a) Administratori/ët i shoqërisë duhet të plotësojë kërkesat e parashikuara në germa a), b), d), e) dhe g) të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
 - b) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të administrimit të shoqërisë duhet të plotësojnë kërkesat e parashikuara në germa a), d), e) dhe g) të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
 - c) Veprimtaria e brokerimit në emër dhe për llogari të shoqërisë do të kryhet nga brokeri/at në sigurime të licencuar nga Autoriteti;
 - d) Shoqërisë nuk i është revokuar më parë licenca sipas parashikimeve të nenit 211 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014.

Neni 8

Dokumentacioni i licencimit të shoqërisë së brokerimit në sigurime

1. Personi juridik, i cili kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e brokerimit në sigurime, paraqet pranë Autoritetit një kërkesë me shkrim, sipas formë kërkesës të paraqitur në aneksin 2 të kësaj rregullore, të shoqëruar nga:
 - a) Projekti i statutit;
 - b) Të dhëna mbi strukturën aksionare dhe organizative të shoqërisë;
 - c) Të dhëna për aksionarët, administratorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit Administrimit dhe personelin, si dhe personat e ngarkuar nga shoqëria për të kryer veprimtari brokerimi për shoqërinë;
 - d) Për administratorin/ët, dokument në plotësim të germës a), b), d), e) dhe g) të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
 - e) Për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të Administrimit, dokument në plotësim të germës a), d), e) dhe g) të nenit 3 të kësaj rregulloreje;
 - f) Plani i biznesit për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit, i cili tëpërfshijë edhe detaje të zhvillimit të tij dhe projektimet financiare;
 - g) Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikat dhe/ose procedurat për:
 - i. Njohjen e konsumatorit;
 - ii. Mënyrën e trajtimit të ankesave;
 - iii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit nëpërputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - iv. Trajtimin e konfliktit të interesit;
 - v. Funkcionin e përputhshmërisë që siguron përputhjen e aktivitetit të shoqërisë së brokerimit me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
 - gj) Adresa në të cilin do të ushtrojë veprimtarinë e brokerimit;
 - h) Dokumenti bankar që vërteton pagimin e kapitalit bazë, prej të paktën 3,000,000 lekë në një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e RSH;
 - i) Kontrata e punësimit me kohë të plotë për të paktën një broker të licencuar;
 - j) Deklarata për mos qenie palë e lidhur me një shoqëri sigurimi.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruar duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopjetë noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.
3. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse eçmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 9

Ushtrimi i veprimtarisë së brokerimit në sigurimenga banka dhe/ose dega e bankës së huaj

1. Banka dhe/ose dega e bankës së huaj, e cila kërkon të kryejë veprimtarinë e brokerimit në sigurime, pasi të ketë marrë miratimin nga Banka e Shqipërisë, aplikon në Autoritet për të marrë miratimin për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime.
2. a) Banka dhe/ose dega e bankës së huaj, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit duhet t'i ofrojë në mënyrë transparente klientit çdo policë sigurimi që ndërmjetëson. Klienti ka të drejtë të zgjedhë policën e sigurimit;
b) Banka dhe/ose dega e bankës së huaj duhet të respektojë kërkesat e ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” në ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimin.
3. Veprimtaria e brokerimit në sigurime nga banka dhe/ose dega e bankës së huaj ushtrohet nëpërmjet brokerit të licencuar.

Neni 10

Dokumentacioni për licencimin e bankës dhe/ose degës së bankës së huaj për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime

1. Kërkesa me shkrim, sipas formës të paraqitur në aneksin 3 të kësaj rregullore, e paraqitur nga Banka dhe/ose dega e bankës së huaj, për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime, shoqërohet me:
 - a) Miratimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime;
 - b) Të dhëna për strukturën/njësienë e brokerimit;
 - c) Plani i biznesit për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit;
 - d) Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikën dhe/ose procedurat për:
 - i. Njohjen e konsumatorit;
 - ii. Mënyrën e trajtimit të ankesave;
 - iii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit nëpërputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - iv. Trajtimin e konfliktit të interesit;
 - v. Funksionin e përputhshmërisë që siguron përputhjen e aktivitetit të shoqërisës së brokerimit me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
 - e) Listën e brokerave të licencuar.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruar duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopjetë noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.

3. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse eçmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 11

Ushtrimi veprimtarisë së brokerimit në sigurime nga dega e shoqërisë së huaj të brokerimit

1. Dega e shoqërisë së huaj të brokerimit, e cila kërkon të ushtrojë veprimtari brokerimi duhet të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e brokerimit në sigurime nga Autoriteti.
2. Për licencimin e degës së shoqërisë së huaj të brokerimit, zbatohet rregullat e përcaktuara në nenet 7 dhe 8 të kësaj rregullore.
3. Dega e shoqërisë së huaj të brokerimit e cila kërkon të pajiset me licencë për të kryer veprimtarinë e brokerimit në sigurime, përveç dokumentacionit të përcaktuar në nenin 8 të kësaj rregullore paraqet edhe:
 - a) Statutin e shoqërisë së huaj, apo aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të vendit te origjinës se shoqërisë se huaj;
 - b) Dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në vendin ku ushtron veprimtari si dhe licencën/miratimin për të kryer aktivitet brokerimi në sigurime të lëshuar autoriteti përgjegjës;
 - c) Vendimin e organit drejtues të shoqërisë së huaj për shtrirje të veprimtarisë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - d) Dokumentacionin, që vërteton statusin aktual të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit, përfshirë informacionin nëse është në proceslikuidimi apo falimentimi;
 - e) Bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria ka pasur veprimtari për më shumë se një vit;
 - f) Miratimin zyrtar për hapjen e degës së shoqërisë së huaj dhënë nga autoriteti përgjegjës i vendit ku ndodhet selia qendrore e saj.
4. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopjetë noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.
5. Autoriteti, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse eçmon të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 12

Ruajtja e kërkesave të licencimit dhe miratimi i ndryshimeve

1. Kërkesat për licencimin e subjekteve të përcaktuara në këtë rregullore duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës që licencat janë të vlefshme. Monitorimi i përmbushjes së kërkesave bëhet nga Autoriteti offsite një herë në vit dhe nëpërmjet inspektimeve në vend kur e gjykon të arsyeshme.
2. Brokëri, person fizik, duhet që çdo 3 vjet të kryejë kualifikime profesionale dhe të paraqesë dokumentin përkatës në AMF.
3. Subjekti njofton me shkrim Autoritetin për çdo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave është dhënë licenca. Çdo ndryshim miratohet nga Autoriteti.

Kreu IV

Procedurat e licencimit

Neni 13

Procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit dhe afatet e licencimit

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi për licencë në përputhje me kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 52/2014, datë 22.05.2014 dhe në këtë rregullore.
2. Autoriteti nëse vëren mangësi apo pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur, apo nëse e gjykon të nevojshme, njofton kërkuesin për miratim/licencim për plotësimin e tyre brenda një afati 30 ditor. Ky afat mund të zgjatet edhe me 30 ditë të tjera për arsye të justifikuara. Nëse pas përfundimit të afatit, nuk plotësohet dokumentacioni, shqyrtimi i kërkesës/aplikimit ndërpritet. Në rast riaplikimi, dokumentacioni duhet të depozitohet nga e para.
- 2/1. Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kritereve të përshtatshmërisë dhe integritetit të personit juridik, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.
3. Autoriteti, brenda 2 muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë nga ana e kërkuesit për licencë, jep ose refuzon licencën për ushtrim veprimtarie brokerimi në sigurime.

4. Pajisja me licencë për ushtrim veprimtarie brokerimi në sigurime shoqërohet me pagesën e tarifës për llogari të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 14

Licenca

1. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit është e patransferueshme dhe e patregtueshme.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit është e përcaktuar sipas klasave të sigurimit.
3. Licenca përgatitet në dy kopje, në gjuhën shqipe. Një kopje i jepet të licencuarit dhe një kopje arkivohet në AMF.
4. Format i licencës për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit paraqitet në aneksin 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Rastet e refuzimit të licencës

1. Autoriteti refuzon kërkesën për pajisje me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në rastet kur:
 - a) Për personin fizik, nuk përmbushen kërkesat e Ligjit nr. 52/2014, dt. 22.05.2014, dhe të neneve 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje;
 - b) Për personin juridik, nuk përmbushen kërkesat e Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014, dhe të neneve 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje;
 - c) Për bankën dhe/ose degën e bankës së huaj nuk përmbushen kërkesat e Ligjit nr.52/2014, dt. 22.05.2014, dhe të neneve 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje;
 - d) Për degën e shoqërisë së huaj të brokerimit, në rastet kur nuk përmbushen kërkesat e Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014, dhe të nenit 11, të kësaj rregulloreje.
2. Ka kryer shkelje të legjislacionit të zbatueshëm në fushën e sigurimeve.
3. Vendimi i refuzimit i bëhet i ditur me shkrim kërkuarit, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së tij.

Neni 16
Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe garancia financiare

Personi fizik apo juridik që kërkon të ushtrojë veprimtari brokerimi në sigurime, pas marrjes së licencës nga Autoriteti, por para regjistrimit në QKR dhe fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, duhet të disponojë:

- a) Sigurimin e përgjegjësisë profesionale sipas parashikimeve të nenit 205 të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014;
- b) Dokumentin bankar që vërteton depozitimin në një llogari qëllimore të shumës prej 1,000,000 lekë si garanci financiare.

Kreu V
Të Fundit

Neni 17
Dispozita kalimtare

1. Të gjithë personat juridikë të licencuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje duhet të plotësojnë dokumentacionin sipas kërkesave të kësaj rregulloreje brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e saj.
2. Të gjithë brokerat fizikë që u ka përfunduar afati i licencës apo e kanë të vlefshme atë deri në 31.12.2015 do të aplikojnë për licencë duke përmbushur kërkesat e pikës 1 germa a), d), e), f) dhe g) të nenit 3 të kësaj rregulloreje.
3. Të gjithë brokerat e tjerë fizikë që u përfundon licenca përtej afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, do të aplikojnë për licencë duke përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**FORMË-KËRKESË
PËR
PAJISJE ME LICENCË “BROKER NË SIGURIME”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores ----
----- “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të
ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore unë,

**Z/Znj. _____, paraqes kërkesën për pajisje me licencë
“Broker në Sigurime”, si person fizik.**

1. Të dhënat personale janë si më poshtë:

Emri

Atësia

Mbiemri

Adresa e vendbanimit:

Rruga, Qyteti/Fshati, Bashkia.....

Adresa ku do të ushtrohet veprimtaria / selia:

.....

Nr. kontakti:

Tel, Fax

Faqe interneti.....; Adresë e-mail.....

2. Veprimtaria e brokerimit do të ushtrohet në:

A. Klasat e sigurimit të Jo-Jetës

B. Klasat e sigurimit të Jetës

C. Risigurim

**Nëpërmjet plotësimit të formular kërkesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur këtij
formulari, deklaroj se informacioni i paraqitur është i plotë, i vërtetë, i saktë dhe nuk
përmban fshehje të fakteve.**

Trajtimi i të dhënave personale në këtë formë kërkesë dhe dokumentacionit bashkëngjitur do të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi .

Personi Kërkues:

Data _____

(Emër, Mbiemër, Nënshkrim)

Shënim:

- 1. Përzgjedhja e klasave në të cilën do të ushtrohet veprimtaria, do të argumentohet me përvojën dhe trajnimet e kryera nga aplikanti, si dhe mbi bazën e rezultateve të testimit.*
- 2. Kjo formë kërkesë është e pavlefshme nëse nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm.*

DOKUMENTACIONI SHOQËRUES I FORMATIT TË KËRKESËS SË APLIKIMIT PËR LICENCË BROKERI NË SIGURIME

Personi fizik që kërkon të pajiset me licencë brokeri në sigurime, duhet të paraqesë:

- a) CV dhe kopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Diplomë universitare;
- c) Dokument që vërteton përvojën profesionale në fushën e sigurimit;
- d) Dokument që vërteton kryerjen e kualifikimit profesional;
- e) Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- f) Deklaratë që nuk ka qenë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- g) Deklaratë që nuk është i punësuar me kohë të plotë në funksione publike, apo në ndonjë shoqëri sigurimi;
- h) Deklaratë që nuk ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese ndaj të tretëve;
- i) Dokument që vërteton se nuk ka detyrime fiskale të papaguara në afat, të lëshuar nga administrata tatimore.

Shënim: Personi fizik që kërkon të ushtrojë veprimtari brokerimi në sigurime, pas marrjes së licencës nga Autoriteti, por para regjistrimit në QKR dhe fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, duhet të disponojë:

- a) Sigurimin e përgjegjësisë profesionale sipas parashikimeve të nenit 205 të Ligjit nr. 52/2014, dt. 22.05.2014;
- b) Dokumentin bankar që vërteton depozitimin në një llogari qëllimore të shumës prej 1,000,000 lekë si garanci financiare.

**FORMË-KËRKESË
PËR
PAJISJE ME LICENCË “SHOQËRI BROKERIMI NË SIGURIME”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores nr., dt..... “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore unë,

Z/Znj. _____, **përfaqësues ligjor i**
shoqërisë _____,

paraqes kërkesën për pajisje me licencë “Shoqëri Brokerimi në Sigurime”.

1. Veprimtaria e brokerimit si person juridik do të kryhet si :

- Shoqëri Brokerimi Degë e shoqërisë së huaj të brokerimit

2. Të dhënat e personin juridik që do të ushtrojë veprimtari janë:

Emri i shoqërisë.....sh.a.

Adresa ku do të ushtrohet veprimtaria / selia:

.....

Nr. kontakti:

Tel, Fax

Faqe interneti.....; Adresë e-mail.....

3. Veprimtaria e brokerimit do të ushtrohet në:

A. Klasat e sigurimit të Jo-Jetës

B. Klasat e sigurimit të Jetës

C. Risigurim

4. Brokeri/at e punësuar të shoqërisë do të jenë:

Emër.....	Mbiemër.....	Licencë, nr..... dt.....
Emër.....	Mbiemër.....	Licencë, nr..... dt.....
Emër.....	Mbiemër.....	Licencë, nr..... dt.....

Nëpërmjet plotësimit të formular kërkesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur këtij formulari, deklaroj se informacioni i paraqitur është i plotë, i vërtetë, i saktë dhe nuk përmban fshehje të fakteve.

Trajtimi i të dhënave personale në këtë formë kërkesë dhe dokumentacionin bashkëngjitur do të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi .

Personi Kërkues:

Data _____

(Emër, Mbiemër, Nënshkrim)

Shënim:

- 1. Përzgjedhja e klasave në të cilën do të ushtrohet veprimtaria, do të argumentohet nga plani i biznesit, rregullat e brendshme, si dhe licenca e brokerave të punësuar.*
- 2. Kjo formë kërkesë është e pavlefshme nëse nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm.*

DOKUMENTACIONI SHOQËRUES I FORMATIT TË KËRKESËS SË APLIKIMIT PËR LICENCË BROKERI NË SIGURIME

A. Personi juridik (shoqëri brokerimi) që kërkon të pajset me licencë brokeri në sigurime duhet të paraqesë:

1. Projekt statutin;
2. Të dhëna mbi strukturën aksionare dhe organizative të shoqërisë;
3. Të dhëna për aksionarët, administratorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të administrimit dhe personelin, si dhe personat e ngarkuar nga shoqëria për të kryer veprimtari brokerimi për shoqërinë;
4. Për administratorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës/Këshillit të Administrimit:
 - i. CV dhe kopje të dokumentit të identifikimit;
 - ii. Diplomë universitare;
 - iii. Dokument që vërteton kryerjen e kualifikimit profesional (vetëm për administratorin);
 - iv. Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
 - v. Deklaratë që nuk ka qenë dënuar për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese e piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
 - vi. Deklaratë që nuk ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paafësisë paguese ndaj të tretëve si dhe nuk ka detyrime të papaguara ndaj organeve tatimore.
5. Plani i biznesit për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit, i cili të përfshijë edhe detaje të zhvillimit të tij dhe projektimet financiare;
6. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politika dhe/ose procedura për:
 - i. Njohjen e konsumatorit;
 - ii. Mënyrën e trajtimit të ankesave;
 - iii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - iv. Trajtimin e konfliktit të interesit;
 - v. Funksionin e përputhshmërisë që siguron përputhjen e aktivitetit të shoqërisë së brokerimit me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
7. Adresën në të cilin do të ushtrojë veprimtarinë e brokerimit;
8. Dokumentin bankar që vërteton depozitimin e kapitalit bazë, prej të paktën 3,000,000 lekë në një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e RSH.;
9. Kontrata e punësimit me kohë të plotë për të paktën një broker të licencuar;
10. Deklarata për mos qenie palë e lidhur me një shoqëri sigurimi.

B. Dega e shoqërisë së huaj të ndërmjetësimit që kërkon të pajiset me licencë brokeri në sigurime duhet të paraqesë:

1. Statutin e shoqërisë së huaj, apo aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të vendit të origjinës së shoqërisë së huaj;
2. Dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në vendin ku shtrihet veprimtari si dhe licencën për të kryer aktivitet brokerimi në sigurime të lëshuar autoriteti përgjegjës;
3. Vendimin e organit drejtues të shoqërisë së huaj për shtrirje të veprimtarisë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
4. Dokumentacionin, që vërteton statusin aktual të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;
5. Bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria ka pasur veprimtari për më shumë se një vit;
6. Miratimin zyrtar për hapjen e degës së shoqërisë së huaj dhënë nga autoriteti përgjegjës i vendit ku ndodhet selia qendrore e saj;
7. Dokumentacionin e përmendur në pikën 2-10 të seksionit A të këtij formulari.

Shënim: Personi juridik që kërkon të ushtrojë veprimtari brokerimi në sigurime, pas marrjes së licencës nga Autoriteti, por para regjistrimit në QKR dhe fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, duhet të disponojë:

- a) Sigurimin e përgjegjësive profesionale sipas parashikimeve të nenit 205 të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014;
- b) Dokumentin bankar që vërteton depozitimin në një llogari qëllimore të shumës prej 1,000,000 lekë si garanci financiare.



**FORMË-KËRKESË
PËR
PAJISJE ME LICENCË “BANKA SI SHOQËRI BROKERIMI NË SIGURIME”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores ----
----- “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të
ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore unë,

Z/Znj. _____, **përfaqësues ligjor i shoqërisë** _____, paraqes kërkesën për pajisje me licencë
“Ushtrim Veprimtarie Brokerimi në Sigurime”.

1. Të dhënat e Bankës dhe/ose degës së bankës së huaj që do të ushtrojë veprimtari janë:

Emri i shoqërisë sh.a

Nr. NIPT-i

Adresa ku ushtrohet veprimtaria / selia:

.....

Nr. kontakti:

Tel, Fax

Faqe interneti.....; Adresë e-mail.....

2. Të dhënat e drejtuesit të strukturës/njesisë së brokerimit do të jetë:

Emri

Atësia

Mbiemri

Nr. kontakti:

Tel, Fax

Faqe interneti.....; Adresë e-mail.....

3. Veprimtaria e brokerimit do të ushtrohet në:

A. Klasat e sigurimit të Jo-Jetës

B. Klasat e sigurimit të Jetës

C. Risigurim

4. Brokëri/at e punësuar në shoqëri do të jenë:

Emër..... Mbiemër..... Licencë, nr..... dt.....

Emër..... Mbiemër..... Licencë, nr..... dt.....

Emër..... Mbiemër..... Licencë, nr..... dt.....

Nëpërmjet plotësimit të formular kërkesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur këtij formulari, deklaroj se informacioni i paraqitur është i plotë, i vërtetë, i saktë dhe nuk përmban fshehje të fakteve.

Trajtimi i të dhënave personale në këtë formë kërkesë dhe dokumentacionit bashkëngjitur do të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Personi Kërkues:

(Emër, Mbiemër, Nënshkrim)

Data _____

Shënim:

- 1. Përzgjedhja e klasave në të cilën do të ushtrohet veprimtaria, do të argumentohet nga plani i biznesit, rregullat e brendshme, si dhe licenca e brokerave të punësuar.*
- 2. Kjo formë kërkesë është e pavlefshme nëse nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm.*

DOKUMENTACIONI SHOQËRUES I FORMATIT TË KËRKESËS SË APLIKIMIT PËR LICENCË BROKERI NË SIGURIME

Banka dhe/ose dega e bankës së huaj që kërkon të ushtrojë veprimtari brokerimi në sigurime duhet të paraqesë:

1. Dokument që vërteton miratimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime;
2. Të dhëna për strukturën/njësine e brokerimit;
3. Plani i biznesit për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së brokerimit;
4. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politika dhe/ose procedura për:
 - i. Njohjen e konsumatorit;
 - ii. Mënyrën e trajtimit të ankesave;
 - iii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
 - iv. Trajtimin e konfliktit të interesit;
 - v. Funkcionin e përputhshmërisë që siguron përputhjen e aktivitetit të bankës si shoqëri brokerimi me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Shënim: Banka dhe/ose dega e bankës së huaj që kërkon të ushtrojë veprimtari brokerimi në sigurime, duhet të disponojë:

- a) Sigurimin e përgjegjësisë profesionale sipas parashikimeve të nenit 205 të Ligjit nr. 52/2014, dt. 22.05.2014;
- b) Garancinë financiare prej të paktën 1,000,000 lekë të depozituar në një llogari qëllimore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

FOTO
PERSONALE

L I C E N C Ë

PËR USHTRIM VEPRIMTARIE BROKERIMI NË SIGURIME

Nr.—, datë————

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të Rregullores———— dhe të Vendimit nr. ———, datë ——— të Bordit të AMF-së,

L I C E N C O N

Z. _____

PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BROKERIMI NË SIGURIME

Licenca është e patransferueshme dhe e patregtueshme.
Licenca është me afat të pacaktuar.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

amf ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

L I C E N C Ë

PËR USHTRIM VEPRIMTARIE BROKERIMI NË SIGURIME

Nr.—, datë —————

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të Rregullores————— dhe të Vendimit nr. ———, datë ———— të Bordit të AMF-së,

L I C E N C O N

SHOQËRINË “..... ”, SH.A.

PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BROKERIMI NË SIGURIME

Licenca është e patransferueshme dhe e patregtueshme.
Licenca është me afat të pacaktuar.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV